

Akt Themelimi dhe Statut
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

3 WEBBERS SH.P.K

1. ISMET AHMETI, i biri i PËRPARIM-it, i datelindjes 06/06/1995, lindur ne Lushnje, Shqiperi dhe banues ne Lushnje me adrese: Rr. Misto Mame, Godina 192,Lagjia Gafurr Muco,Lushnje, mbajtesi i leternjoftimit me Nr pashaporte J50606117Q
2. KEVIN BUNDO, i biri i GRAMOS-it, i datelindjes 18/05/1995, lindur ne Fier, Shqiperi dhe banues ne Tirane me adrese: Rr.Koco Miho, ndertesa 131, Njesia Bashkiake nr 4, Tirane, mbajtesi i leternjoftimit me Nr. 032101378
3. JONIS MULAJ, i biri i KOLË-it, i datelindjes 12/09/1995, lindur ne Tirane, Shqiperi dhe banues ne Tirane me adrese: Rr. Nuri Arapi, Godina 62, Senatorium, Tirane, mbajtesi i leternjoftimit me Nr. 032056350


në bazë të Ligjit nr.9901/2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, të ndryshuar, në vijim referuar dhe si Ligji Tregtar, themelojnë këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

KREU I

Forma, emertimi, objekti, selia, kohezgjatja dhe vula

NENI 1

(1) Shoqëria krijohet si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e cila ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dhe sidomos Ligjit nr.9901/2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” të ndryshuar.



(2) Shoqëria është person juridik Shqiptar, i cili do të ushtroje aktivitetin në territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 2

Emertimi i shoqërisë është: “3 WEBBERS” SH.P.K.

NENI 3

Objekti i aktivitetit ekonomik do të jetë: Programim software, Marketing Online, ndërtim dhe dizajnim Website, shërbime hostimi, search engine optimization, ndërtim dhe mirëmbajtje e rrjetit, mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit, zhvillimi I softwareve të shitjes dhe marketingut, instalimin e kompjuterëve dhe pajisjeve të zyrës .

NENI 4

Selia e shoqërisë “3 WEBBERS SHPK” do të jetë: Rr.Mahmut Allushi, Pallati “Jora”, dyqani nr.6, Njesia Administrative Nr.12, Tirane,

NENI 5

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar.

NENI 6


(1) Shoqëria do të ketë vulën e saj ku do të vendoset: emërtesa e shoqërisë dhe numëri i identifikimit të personit të tatueshëm. Vula mund të ketë edhe vetëm inicialet “3 WEBBERS” dhe numëri i identifikimit të personit të tatueshëm.

(2) Shoqëria do të ketë dhe faqe zyrtare në internet e deklaruar në mënyrë vullnetare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KREU II

Kapitali Themeltar, Kontributi, Pjeset e Kapitalit Themeltar.

NENI 7



Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lek, i ndarë në 3 (tre) kuota nga të cilat 2 (dy) kuota do të kenë secila vlerë nominale 33,33 (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lek dhe 1 (një) kuotë me vlerë nominale 33,34 (tridhjet e tre pikë tridhjetë e katër) lek.

NENI 8

Kapitali themeltar është i ndarë sipas kontributeve si më poshtë dhe zotërohet:

1. JONIS MULAJ zotëron 1 (një) kuotë, kontributi 33 330 leke, që përbën 33,33 % te kapitalit të shoqërisë.
2. KEVIN BUNDO zotëron 1 (një) kuotë, kontributi 33 330 leke, që përbën 33,33 % te kapitalit të shoqërisë.
3. ISMET AHMETI zotëron 1 (një) kuotë, kontributi 33 340 leke, që përbën 33,34 % te kapitalit të shoqërisë.

NENI 9


Pjeset e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve të shoqërisë, ndërsa tek të tretët transferohen vetëm me miratimin e Asamblese së Ortakëve.

NENI 10

Asambleja e Ortakëve, mund të zmadhojë dhe zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar dhe legjislacionit në fuqi.

KREU III **Asambleja e Ortakëve**

NENI 11



(1) Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë. Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve thirret në përputhje me Ligjit Tregtar nga të 3 Administratorët sa herë që e konsiderojnë të arsyeshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë. Thirrja e asamblesë mund të bëhet edhe nga personat e tjerë të parashikuar nga legjislacioni. Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve duhet të thirret të paktën tre herë gjatë një viti financiar dhe mbahet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër.

(2) Mbledhja e Asamblesë thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë drejtuar çdo Ortaku, dhe duhet të njoftohet të paktën 7 ditë kalendrike përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat dhe informacionin e përcaktuar në Ligjit Tregtar.

(3) Në rast se në mbledhje janë prezent ortakët që përfaqësojnë 100 % të kapitalit, atëherë njoftimi me respektimin e afatit 7 ditor nuk është i nevojshëm.


NENI 12

Kuorumi dhe kompetencat

(1) Asambleja nuk mund të marrë asnjë vendim nëse nuk është plotësuar kuorumi i parashikuar në Ligjit Tregtar. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

(2) Asambleja e Ortakëve ushtron cdo kompetencë që ligji ose Statuti dhe akti i theelimit e parashikon si:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- emëron, liron dhe/ose shkarkon administratorët;
- ndryshimin e statutit të shoqërisë;
- Shpërndarjen e dividendit;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- riorganizimin e shoqërisë;
- miraton marrje kredi ose huaje; miraton shitje të aktiveve të shoqërisë; miraton blerje pasuri të paluajtshme ose nënshkrim kontratë premtim shitje pasuri të paluajtshme;



- merr vendime për pjesëmarrje në shoqëri të tjera dhe për nënshkrim marrëveshjesh për krijim shoqëri të thjeshta;
- merr vendime në lidhje me shkëmbim pasuri të paluajtshme ose marrëveshje për shkëmbim pasuri të paluajtshme që do të ndërtohen në të ardhmen;
- vendos për prishjen, likudimin e shoqërisë.
- merr vendime të tjera që ligji ja lejon vetëm asamblesë së shoqërisë.

NENI 13

Përfaqësimi në Asamble

- (1) Ortaku mund të autorizojë me shkrim persona të tjerë sipas dispozitave të Ligji Tregtar për ta përfaqësuar atë në mbledhjet e Asamblesë.
- (2) Autorizimi origjinal me shkrim apo një kopje e noterizuar duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë deri para orarit të fillimit të mbledhjes.

TITULLI V


Administrimi i Shoqërisë

NENI 14

- (1) Shoqëria do të administrohet nga 3 (tre) administratorë.
- (2) Administratorët emërohen nga Asambleja e Ortakëve me shumicë të thjeshtë, me një afat deri 5 vjet me të drejtë riemërimi. Afati i emërimit të administratorëve fillon nga data e emërimit të tyre me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- (3) Asambleja e Ortakëve mund të shkarkojë/lirojë Administratorët në çdo kohë.

NENI 15

- (1) Administratorët janë përfaqësuesit ligjor të Shoqërisë, dhe kanë të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet. Administratorët nuk kanë kufizime në lidhje me tagrat e përfaqësimit, për kryerjen e veprimeve të caktuara tregtare dhe/ose veprime me vlerë të caktuar.



(2) Administratorët, së bashku ose secili veç e veç kryejnë administrimin e shoqërisë duke nënshkruar aktet dhe duke kryer çdo aktivitet që lidhet me administrimin e shoqërisë që ligji ose statuti nuk e përcakton si kompetencë të Asamblesë së Ortakëve. Përfundimisht për thirrjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme duhet nënshkrimi i secilit administratorë dhe thirrja me nënshkrim të njërit ose dy administratorëve nuk është e vlefshme.

(3) Administratorët e parë të shoqërisë, të emëruar me afat 5 vjeçar, janë :

- ISMET AHMETI, shtetas shqiptar, identifikuar me pasaportë Nr. J50606117Q
- KEVIN BUNDO, shtetas shqiptar, identifikuar me leternjoftimi me Nr.032101378.
- JONIS MULAJ, shtetas shqiptar, identifikuar me leternjoftim Nr.032056350.

(4) 1) Administratorët, për punën e tyre përfitojnë paga, shpërblime dhe/ose të ardhura që vendosen nga Asambleja e Ortakëve.

NENI 16


Administratori/t kanë këto kompetenca që i ushtrojnë secili veç e veç ose së bashku:

- Te kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politika tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
- Te përfaqësojë shoqërinë tregtare.
- Te kujdeset për mbajtjen e sakte dhe të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërisë.
- Te përgatitë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures se veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumenta përpara asamblese së përgjithshme për miratim.
- Te raportojë përpara asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarive të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- Cdo detyrë tjetër të lejuar nga legjislacioni dhe statuti dhe akti i themelimit të shoqërisë.

KREU IV

Viti financiar, llogaritë vjetore, ndarja e fitimit.

NENI 17



Viti financiar

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor të cdo viti.

NENI 18

Prishja dhe likuidimi

(1) Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga Ligji Tregtar. Prishja e Shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi.

(2) Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet procedurës normale ose të thjeshtëzuar, sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.

(3) Likuidimi i Shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e Pjesës përkatëse të Ligjit Tregtar.

NENI 19

Shndërrimi i shoqërisë në një formë tjetër kryhet me vendim të asamblese së ortakeve.

NENI 20

Punësimi në shoqëri i punonjësve, do të bëhet mbi bazën e kontratave të punës.

NENI 21

Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit, ndërmjet ortakeve të shoqërisë do të zgjidhen me mirëkuptimin ndërmjet tyre dhe nëse mirëkuptimi nuk arrihet palët i drejtohen gjykatës kompetente.

NENI 22

Për çështjet që nuk janë parashkuar në këtë akt themelimi dhe statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.


NENI 23

Ky akt themelimi dhe statut nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale me fuqi te barabarte ligjore.

Ky Akt Themelimi dhe Statut nënshkruhet sot në datë 24/02/2021.

Ortakët

ISMET AHMETI

Ismet Ahmeti


KEVIN BUNDO

Kevin Bundo


JONIS MULAJ

Jonis Mulaj
